

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2833 Prot.

Durrës, më 04.12.2025

V E N D I M

Nr. 109, Datë 04.12.2025

PËR

**"MIRATIMIN E DETAJIMIT TË GRANTIT SHITESË
PËR VITIN 2025, PËR UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës".**

Në zbatim të ligjit Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"; të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", të ndryshuar, të Udhëzimit nr. 20, datë 20.09.2019 të MAS dhe MFE "Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor", të VKM-së nr.75, datë 12.02.2018 "Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor", të Statutit dhe të Rregullores së UAMD; të shkresës nr.7052/1, datë 14.11.2025 të Ministrisë së Arsimit, administruar pranë UAMD-së me Nr. 2758 prot., datë 26.11.2025 me objekt "Për ndryshime në planin e buxhetit të vitit 2025", Relacionit nr.2716/1 prot., datë 03.12.2025 të Administratorit, vendimit të Senatit Akademik nr.172, datë 03.12.2025, Bordi i Administrimit

V E N D O S I:

1. Miratimin e detajimit të grantit shtesë për vitin 2025, për Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës, bashkëlidhur këtij vendimi tabela nr.1.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi:

- Administratori
- Drejtoria e Administrimit Financiar

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

